



Australian Government



Pas vaksinimit tuaj me Comirnaty (Pfizer) kundër COVID-19

Përditësuar së fundi herë: 18 gusht 2021

Rreth vaksinës

Sot ju keni marrë **vaksinën Comirnaty (Pfizer Australia Pty Ltd)**.

Kjo vaksinë mund të parandalojë që njerëzit të sëmurën nga COVID-19. Vaksinë Pfizer kundër COVID-19 nuk përmban ndonjë virus të gjallë, dhe nuk mund t'ju japë COVID-19. Ai përmban kodin gjenetik për një pjesë të rëndësishme të virusit SARS-CoV-2 të quajtur proteina spike. Sistemi juaj imun pastaj do të njeh dhe do të lufton virusin SARS-CoV-2. Kodi gjenetik do të shpërbëhet shpejtë.

Çfarë duhet të pritni pas vaksinimit

Ashtu si dhe me çdo vaksinë, mund të keni disa efekte anësore pas marrjes së vaksinës për COVID-19.

Efektet anësore të **zakonshme** pas **Pfizer** përfshijnë:

- dhimbje ose ënjtje në vendin e injektimit
- lodhje
- kokëdhembje
- dhimbje të muskujve
- ethe dhe të dridhura
- dhimbje të nyjeve.

Efektet anësore **më pak të zakonshme** pas **Pfizer** përfshijnë:

- skuqje në vendin e injektimit
- të përzier
- nyje limfatike të zgjeruara
- ndjenja e të qenurit të sëmurë
- dhimbje të gjymtyrëve
- pagjumësi
- kruarje në vendin e injektimit.

Këto efekte anësore zakonisht janë të lehta dhe zakonisht largohen brenda një ose dy ditëve. Disa marrës do të përjetojnë simptome më të dukshme të ngjashme me gripin nga ky vaksinim në krahasim me vaksinimet e tjera të zakonshme dhe mund të duhet pushim nga aktivitetet normale. Këto simptome mund të paraqiten pas cilësdo dozë por më të zakonshme janë pas dozës së dytë.

Nëse keni dhimbje në vendin e injektimit ose ethe, dhimbje koke ose dhimbje të trupit pas vaksinimit, mund të merrni paracetamol ose ibuprofen. Këto ndihmojnë në zvogëlimin e disa simptomave të përmendur më lartë (nuk ka nevojë të merrni paracetamol ose ibuprofen para vaksinimit). Nëse ka ënjtje në vendin e injektimit, mund të përdorni një kompresë të ftohtë.

Efektet anësore të **rralla** që janë raportuar pas **Pfizer** janë:

- reaksion i rëndë alergjik (anafilaksi)
- miokardi (inflamacion i muskujve të zemrës) dhe perikardi (inflamacion i mbështjellësit të jashtëm të zemrës). Shumica e rasteve janë të buta, dhe që janë shëruar shpejt, edhe pse pasojat në afat më të gjatë të këtyre rasteve janë në duke u parë tani. Raste janë raportuar më shumë pas dozës së dytë dhe më shumë tek të rinjtë meshkuj (mosha < 30 vjeç).

Ju duhet të kërkonti kujdes mjekësor pas vaksinimit nëse:

- ju mendoni se keni një reaksion alergjik. Telefononi 000 nëse përjetoni simptoma të rënda, të tilla si vështirësi në frymëmarrje, gulçim, rrahje të shpejtë të zemrës ose kolaps
- keni dhimbje gjoksi, shtypje apo jorehati, rrahje të çrregulluar të zemrës, rrahje të tejkaluara apo 'valëzim', zbehje, gulçim apo dhimbje gjatë frymëmarrjes
- jeni të shqetësuar për një efekt anësor potencial ose keni simptoma të reja ose të papritura
- keni një efekt anësor të pritur të vaksinës e cila nuk është larguar edhe pas disa ditëve.

Për simptomat që nuk janë urgjente, ju mund të takoni ofruesin tuaj të rregullt të kujdesit shëndetësor (zakonisht mjeku juaj familjar).

Monitorimi i sigurisë së vaksinës dhe raportimi i efekteve anësore

Mund të raportoni efekte anësore të dyshimta tek ofruesi i vaksinimit ose tek një profesionist mjekësor. Ata pastaj do të bëjnë një raport formal në emrin tuaj tek departamenti juaj shëndetësor i shtetit ose territorit ose direkt tek Administrata e Mallrave Terapeutike (TGA).

Nëse preferoni ta [raportoni vetë, ju lutemi vizitoni uebfaqen për efektet anësore të asocuara me vaksinët kundër COVID-19 në faqen](#) e internetit të TGA dhe ndiqni udhëzimet nga faqja.

Testimi për COVID-19 pas vaksinimit

Disa efekte anësore nga vaksinimi për COVID-19 mund të jenë të ngjashme me simptomat e COVID-19 (p.sh. ethe). Sidoqoftë, Pfizer nuk përmban virus të gjallë dhe nuk mund të shkaktojë COVID-19. Ju mund të mos keni nevojë të bëni testin për COVID-19 ose të izoloheni:

- nëse keni simptoma të përgjithshme si ethe, dhimbje koke ose lodhje në dy ditët e para pas vaksinimit dhe
- nëse jeni i sigurt që nuk keni simptoma të frymëmarrjes (p.sh. hundë që rrjedh, kollitje, dhimbje fyti, humbje erë ose humbje shije).

Megjithatë, ju duhet të kontrolloni udhëzimet aktuale në shtetin/territorin tuaj për informacionet më të reja. Kjo këshillë mund të ndryshojë në rast të një shpërthimi të COVID-19 në zonën tuaj lokale. Ju ende mund të keni nevojë të bëni një test për COVID-19 nëse plotësoni kritere të tjera, p.sh. ju jeni një kontakt i ngushtë i një rasti të njohur me COVID-19. Nëse jeni në dyshim, kërkoni vlerësim mjekësor.

Mos harroni terminin tuaj të dytë

Është e rëndësishme që ju të merrni dy doza të vaksinës Pfizer kundër COVID-19. Këto dy doza në përgjithësi jepen 3-6 javë larg njëra tjetrës, por intervale më të gjata mund të rekomdohen në rrethana të veçnata. Doza e dytë me gjasë mund të prolongoj kohëzgjatjen e mbrojtjes kundër COVID-19.

Si përdoren informacionet që jepni në terminin tuaj

Për informacione mbi mënyrën se si të dhënat tuaja personale janë mbledhur, ruajtur dhe përdorur vizito <https://www.health.gov.au/using-our-websites/privacy/privacy-notice-for-covid-19-vaccinations>